



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2023:137625

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05578432

C.nr.2023:137626

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari individual Burhan Berisha me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Bega, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A. Th. nga fshati ..., komuna Kaçanik, A. H.- me përfaqësuesin ligjor R. H., L. J. - me përfaqësuesin ligjor M. J. dhe A. B. - me përfaqësuesin ligjor G. B. , të gjithë nga fshati ..., komuna Kaçanik, të cilët me autorizim i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Avokatura Istrefi” Sh. P. K., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “...” me seli ne Prishtinë, për çështjen kontestuese kompensim dëmi, pa mbajtje të seancës, me dt. 16.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I.KONSTATOHET e TËRHEQUR padia e paditësve A. Th. nga fshati Kovaqec, komuna Kaçanik, A. H.- me përfaqësuesin ligjor R. H., L. J. - me përfaqësuesin ligjor M. J. dhe A. B. - me përfaqësuesin ligjor G. B. , të gjithë nga fshati ..., komuna Kaçanik, me numër C.nr.2023:137626 e dt.20.06.2023, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “...” me seli ne Prishtinë, lidhur me çështjen kontestuese kompensim dëmi.

II. Secila palë i përballon shpenzimet e krijuara, ndërsa gjykata konstaton se takës për padi prej 40€ e ka paguar pala paditëse.

## A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, kanë paraqitur padi në këtë gjykatë ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve "...", me të cilën ka kërkuar që të pranohet kërkesëpadia e paditësve dhe të detyrohet e paditura, nga baza e sigurimit të përgjegjësisë, për lëndimet trupore të pësuar në aksidentin e komunikacionit datës 20.05.2023, në fshatin ..., komuna Kaçanik, nga përgjegjësia e automjetit të udhëtarëve Mercedes, me targa ..., i cili ishte i siguruar tek e paditura, të bëjë kompensimin e dëmit material dhe jo material për lëndimet trupore.

Me parashtrësën e datës 25.03.2024 e autorizuar e paditësve, e ka njoftuar gjykatën se paditësit me të paditurën çështjen kontestuese e kanë zgjidhur në procedurë jashtë gjyqësore me marrëveshje, andaj nuk ka interes juridik që çështja të vazhdojë të procedohet në gjykatë dhe i ka propozuar gjykatës që ti ndërpret të gjitha veprimet juridike dhe ta kontastoj të tërhequr padinë e paditësit.

Gjykata me datë 29.03.2024, e ka njoftuar palën e paditur për dhënien e pëlqimit lidhur me kërkesën për tërheqjen e padisë, mire po pala e paditur brenda periudhës së caktuar me ligj, nuk ka deklaruar për tërheqjen e padisë, andaj gjykata konform nenit 261 paragrafi 2 të LPK-së, ku thuhet: *"Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë"*, prandaj gjykata e konsideron se pala e paditur ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Gjykata vendosi që të pranojë të tërhequr padinë e paditësve në kuptim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës kontestimore, në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata vendosi që secila palë ti përballojë shpenzimet e krijuara dhe konstatoi se pala paditëse ka paguar shumën prej 40€ në emër të taksës për padit, në bazë të fletpagesës së dt.25.03.2024, konform nenit 12.1 të UA, të KGJK-së nr. 01/2017 mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:137625  
Datë: 16.04.2024  
Numri i dokumentit: 05578432

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

Dega Kaçanik

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2023:137626, datë. 16.04.2024.

Gjyqtari:

**Burhan BERISHA**

**KËSHILLË JURDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi  
nuk është e lejuar ankesa.